

Njerëz të përkohshëm

Një roman nga David Mitchell

30 Qershor

I HAP ME VRULL PERDET E DHOMËS SË GJUMIT, dhe shoh qiellin e etur dhe lumin e gjërë plot me barka e gjësende, por mua tani më shkon mendja te sytë si çokollatë të Vinit, shampoja nëpër shpinen e Vinit, rruazat e djerses në supet e Vinit, dhe e qeshura e djallëzuar e Vinit, dhe sa nuk më tërbohet zemra dhe, perendi, do të kisha dashur të zgjohesha te Vini ne Pikok Strit dhe jo ne dhomën time kote. Mbrëmë, fjalët u thanë vetvetiu, “Krisht, të dua me të vërtetë, Vin” dhe Vini nxorri një mjegull tymi dhe e bëri zërin si të Princ Çarlit: Njeriu mund të thotë se është tejmase i dhënë edhe pas teje, Holli Sajks,” dhe unë sa nuk u shkula së qeshuri, edhe pse isha pak e mërzhitur se ai nuk ma ktheu me një “Edhe unë të dua.” Të them të drejtën. Por, dashnorët sillen si të krisur për të fshehur ca gjëra, ta thotë çdo revistë këtë. Sa do të doja ta merrja në telefon në këtë çast. Do të doja të shpiknin telefonë me të cilët mund të flasësh me këdo, kudo, kurdo qoftë. Ai do të jetë duke vajtur në punë në Roçester me motoçikletën e tij Norton në këto çaste, me xhaketën e tij nga lëkura ku është shkruar LED ZEP me sumbulla të argjendta. Eja shtator, të mbush 16 vjeç, e të më merrë ai me vete në Nortonin e tij.

Dikush e përplas derën e bufesë poshtë.

Mami. Asnjëri s’do të guxonte ta përplaste derën në atë mënyrë.

Çfarë nëse ajo e ka kuptuar? thotë një zë i ndrydhur

Jo, kemi qenë mjaft të vëmendshëm, Vini dhe unë.

Ajo është në menopauzë, është mami pra. Kjo duhet të jetë.

FIËR OF MJUZIK e grupit Toking Heds po luan në gramafonin tim, prandaj e ul gjilpërën e gramafonit. Vini ma bleu këtë disk të shtunën e dytë që u takuam në Mexhik Bas Rekords. Është

një pllakë e mrekullueshme. Më pëlqen “Hevën” dhe “Memoris Kent Ueit”, por nuk është se ka ndonjë këngë të keqe në të. Vini ka qenë në Nju Jork dhe në fakt i ka parë Toking Heds, për së gjalli. Shoku i tij Deni ishte pjesë e sigurimit dhe e çoi në prapaskenë pas shfaqjes, dhe ai u njoftua me David Bërnin dhe bendin. Nëse shkon prapë vitin e ardhshëm, do të më merrë edhe mua. Po vishem, duke gjetur të mavijosurat e dashurisë në trup me dëshirën për të shkuar te Vini sonte, por ai do të takohet me disa miq në Dovër. Meshkujt e urrejnë kur femrat bëhen xhelozë, prandaj unë shtirem se nuk jam e tillë. Shoqja ime më e mirë Stella ka vajtur në Londër në kërkim të rrobave të dorës së dytë në Kemden Market. Mami mendon se jam akoma e re për të shkuar në Londër pa një të rritur, andaj Stella e mori Ali Xhezopin. Ngazëllimi më i madh për sot do të jetë fshirja e lokalit për t’i fituar tri sterlina para xhepi. Urra! Më pas, duhet të përsëris për provimet e javës së ardhshme. Desh sa nuk i dorrëzova fletat e zbrazëta dhe ti tregoja shkollës ku ti fusin trekëndëshat e Pitagorës dhe *Zotin e mizave* dhe ciklin e jetës së krimbave. Do ta bëja, që ç’ke me të!

Po po! Edhe atë si.

POSHTË NË kuzhinë atmosfera është si në Antarktidë. “Mirmëngjës,” them unë, por vetëm Xhako e ngrit shikimin nga karrigja pranë dritares ku po vizaton. Sheroni ndodhet në dhomën e ditës, duke shikuar një film vizatimor. Babai është poshtë në korridor, duke biseduar me postierin–kamioni nga birraria po gumëzhin përpara lokalit. Mami po pret molla në kube, duke mos ma varur veshin mua. Duhet të them: “Çfarë ka që nuk shkon mami, çfarë kam bërë?” Por nuk ia vlen bara qeranë. Me sa duket e ka vërejtur se mbrëmë u ktheva vonë, por po e lë atë ta

hapë këtë temë. Hedh pak qumësht në drithrat e mija Uitabiks, dhe i vendos mbi tavolinë. Mami e përplas kapakun mbi tenxhere, dhe më afrohet. “Në rregull. Si e arsyeton ti sjelljen tënde?”

“Mirëmëngjes edhe ty, mami. Edhe një ditë e nxehtë.”

“Si e arsyeton sjelljen tënde, zonjushë?”

Nëse je në mëdyshje, hiq sikur nuk di gjë. “Cilën sjellje më saktësisht?”

Sytë e saj po bëhen fare gjarpërues. “Në ç’kohë u ktheve në shtëpi?”

“Mirë, mirë, epo erdha pak vonë, më vjen keq.”

“Dy orë nuk është ‘pak vonë.’ Ku ishe?”

Po e përtyp Uitabiksin tim. “Te Stella. E humba ndjesinë e kohës.”

“Epo, kjo tani me të vërtetë është e çuditshme. Në ora dhjetë e mora në telefon nënën e Stellës të kuptoja ku dreqin ishe ti, dhe e di çfarë? Ti kishe ikur përpara orës tetë. Pra, kush është gënjeshtari në mesin tonë, Holli? Ti ose ajo?”

Se ç’më gjeti. “Pasi ika nga shtëpia e Stellës, dola për shëtitje.”

“Dhe ku të çoi shëtitja ty?”

E theksoj mirë çdo fjalë. “Përgjatë lumit, në rregull?”

“Në pjesën e sipërme ose të poshtme, ishte, kjo shëtitja e shkurtër?”

I lë vend heshtjes pak. “Ç’lidhje ka kjo.”

Dëgjohen ca shpërthime në filmin vizatimor në televizor. Mami i thotë motrës sime, “Fike atë gjënë dhe mbylle derën kur të dalësh, Sheron.”

“Kjo nuk është e drejtë! Holli është ajo që po qortohet.”

“Menjëherë, Sheron. Edhe ti Xhako, dua—“ Por Xhako veçse ia ka mbathur. Kur Sheroni del, mami nis sulmin prapë: “Krejt e vetme, po shëtisje ti?”

Mos ajo po më zë në grackë me këtë hamendësim ngacmues? “Po.”

“Atëherë deri ku shkove ashtu krejt e vetme duke shëtitur?”

“Çfarë—mos do të dish miljet apo kilometrat?”

“Epo, mbase shëtitja yte e vockël të çoi në Pikok Strit, te dikush me emrin Vinsent Kostello?”

Më duket sikur kuzhina po më vjen vërdallë, dhe nga dritarja, në bregun Eseks të lumit, një njeri i imët thatanik, e ngrit biçikletën e tij nga traqeti. “Krejt papritmas nuk po i gjen dot fjalët? Lermë të ta zgjoj kujtesën: mbrëmë ora dhjetë, duke i mbyllur grilat, dritarja e përparme, e veshur me një këmishë dhe pothuajse asgjë tjetër.”

Po, shkova poshtë t’ia çoja Vinit një birra. Po, i lëshova grilat në dhomën e përparme, po, dikush kaloi aty pranë. Qetësohu, i pata thënë vetes. Cilat janë mundësitë që një i panjohur të më ketë njohur? Mami pret që unë ta ul kokën por unë nuk e bëj.

“Po humb kohë duke punuar si banakiere, mami. Duhet të merresh me agjentët e MI5-ës.”

Mami me jep një shikim aq të rreptë si vetëm ajo di. “Sa vjeç është ai?”

Në këtë pikë i kryqëzoj krahët. “S’ka ç’të të duhet ty.”

Sytë e mamit ngrysen. “Njëzet-e-katër, me sa duket.”

“Nëse e di, pse po pyet pra?”

“Sepse kur një njëzet-e-katër vjeçar ngatërrohet me një vajzë pesëmbëdhjetë vjeçe është e kundërligjshme. Mund të futet në burg.”

“Unë do të mbush gjashtëmbëdhjetë vjeç në shtator, dhe ma merr mendja se policia e Kentit ka punë më të mençur për të bërë. Jam mjaftueshëm e rritur sa për të sjellur vendime për lidhjet e mia.”

Mami e ndez një Marlboro të kuqe. Vdes për një të tillë.

“Kur t’ia them babait, ai do ta rrjepë këtë tipin, Kostellon, të gjallë.”

Patjetër, babai duhet t’i dëbojë pijanecat nga lokali kohë pas kohe, të gjithë pronarët e bëjnë këtë, por ai nuk është soji që mund të rrjepë dikë të gjallë. “Brendani ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeç kur dilte me Mendi Frajin, dhe nëse kujton se vetëm kapeshin për dore teksa luhateshin, e ke gabim. Nuk më kujtohet se atij iu tërhoq vëmendja me ‘mund të përfundosh në burg’.”

Ajo ma germëzon sikur jam ndonjë tarallake: “Është-më-ndryshe-për-djemtë.”

Unë e lëshoj një gërhitje të tipit nuk-mund-tu-besoj-veshëve.

“Po ta them vetëm njëherë, Holli, ti do të takohesh prapë me këtë shitësin e veturave, vetëm mbi trupin tim të vdekur.”

“Në fakt, mami, do të takohem, me kë dreqin të dua!”

“Rregulla të reja.” Mami e fik cigaren. “Unë do të të dërgoj në shkollë dhe do të të marr që aty me furgon. Nuk ke për të shkelur përjashta në mos me mua, babin tënd, Brendanin, ose Ruthin. Nëse më zënë sytë atë të degjeneruarin këtu pari, do të ngre padi në polici—do ta bëj andaj Zoti më ndihmoftë. Dhe-dhe-do ta marr në telefon punëdhënësin e tij, që ta dinë se ai josh nxënëse të shkollës.”

Sekondat e tejzgjatura ecin shtruar teksa e gjithë kjo më përshkon. Lotsjellësi im fillon të dridhet por në asnjë mënyrë nuk do t’ia jap znj. Hitler kënaqësinë. “Kjo nuk është Arabia Saudite! Nuk mund të më mbyllësh brenda!”

“Jeton nën çatinë tonë, duhet t’u bindesh rregullave tona. Unë kur isha në moshën tënde—“

“Po, po, sigurisht, ti kishe njëzet vëllezër, tridhjetë motra, dyzet gjyshër, dhe pesëdhjetë akre tokë për të gërmuar, sepse ashtu ishte jeta në Irlandën e ndyrë të dikurshme, por kjo është Anglia mami, Anglia! Dhe janë vitet e 80-ta, dhe nëse jeta ishte aq drejt e lavdishme në atë moçalin e Korkut Perendimor, pse të keqen e more mundimin të vish—“

Fshikullim! Një shuplakë në anën e majtë të fytyrës sime.

Shikojmë njëra-tjetrën: unë duke u dridhur nga tronditja, dhe mami më e inatosur se kurrë, dhe—ma merr mendja—e vetëdijshme se sapo ka prishur diçka që nuk ndreqet më. Unë dal nga dhoma pa thënë asnjë fjalë, sikur sapo kam dalur fituese nga një zënkë.

Unë qaj vetëm pak, dhe është një e qarë e tronditur, e jo me zë të lartë, dhe kur mbaroj së qari dal para pasqyrës. Sytë e mi janë pak të enjtur, por pak laps për sytë e zgjidh problemin ... Një çik buzëkuq, pak hijëzim për mollëza ... E ujditur. Vajza në pasqyrë është një grua, me flokët e saj të prera të zeza, me bluzën e saj me mbishkrimin *Quadrophena*, me xhinset e saj të zeza.

“Kam ca lajme për ty,” thotë ajo. “Sot do të shpërngulesh te Vini.” Filloj të numëroj arsyet pse nuk është e mundur, dhe ndaloj. “Po,” pajtohem, e rrëmbyer dhe e qetë në të njëjtën kohë. Do ta lë edhe shkollën. Që tani. Pushimet verore do të vijnë sa hap e mbyll sytë, dhe unë do të mbush gjashtëmbëdhjetë vjeç në shtator, dhe pastaj ik mbushu ti shkollë e Uindmill Hillit. Po a jam e guximshme?

Si nuk jam. Atëherë, mblidhi plaçkat. Po çfarë? Çfarëdo që mund ta nxerë në çantën e shpinës. Rroba të brendshme, sutjena, bluza, pallton time; çantën e kozmetikës, dhe kutinë Okso me byzylikë dhe gjerdane brenda. Brushën e dhëmbëve dhe një grusht tamponë–periodat më janë vonuar pak, prandaj mund të vijnë në çdo çast. Të holla. I numëroj 13.85 sterlina, të kursyera në banknota dhe monedha. Kam edhe 80 sterlina në librezën e kursimit. Nuk është se Vini do të më kërkojë para për qeranë, dhe si ashtu do të kërkoj punë që javën e ardhshme. Punë si dado, në market, kamariere: Ka kushedi sa mënyra për të fituar ca qindarka. Si t’ia bëj me disqet e mia? Nuk mund ta mbart tërë koleksionin në Pikok Strit tani, dhe mami është mjaft e zonja t’i flak te dyqani Oksfem thjesht nga inati, prandaj e marr vetëm Fiër of Mjuzik, duke e mbështjellur me kujdes me pallton time dhe e vendos në çantë që të mos lakohet. I fsheh të tjerat nën dërrasën e pangjitur të dyshemesë, vetëm përkohësisht, por teksa e shtroj qilimin në vend, e përjetoj frikën më të madhe të jetës: Xhako po më shikon nga pragu i derës. Ai është ende i veshur me pizhamat e tij Thanderbërd dhe me pantofla.

I them, “Zotëri, sapo më shkaktove sulm në zemër. “Ti po shkon,” Xhako e ka një zë që tingëllon si të mos jetë tamam këtu.

“Le të ngelë në mes nesh, po, po shkoj. Por jo shumë larg, mos u merakos.”

“Të kam bërë një dhuratë, që të më mbash mend.” Xhako më jep një rreth kartoni–një kuti djathi Deirili e rrafshuar, me një labirinth të vizatuar në të. Ai është i marrë pas labirintheve, është Xhako pra; janë gjithë ato libra *Birruca dhe Dragonjtë* që ai dhe Sheroni i lexojnë. Labirinhi që e ka vizatuar Xhako është në fakt krejt i thjeshtë sipas parimeve të tij, e përbërë nga tetë ose nëntë qarqe brenda njëra tjetrës. “Merre,” më thotë. “Është i lig.”

“Nuk më duket aq i keq mua.”

“‘I lig’ do të thotë satanik motërzë.”

“Pse është atëherë aq satanik labirinhi yt?”

“Sepse Muzgu të përndjek teksa ec nëpër të. Nëse të prek, ti pushon së ekzistuari, pra një kthesë e gabuar në një rrugë pa dalje, dhe ky është fundi yt. Kjo është arsyeja se pse duhet ta mësosh labirinthin përmendësh.”

“Krisht, nuk e kam aspak të trullësuar vëllaqon. “E vërtetë. Epo, faleminderit, Xhako. Shiko, kam ca gjëra të–“

Xhako më kap për kyçin e dorës. Mësoje këtë labirinth, Holli, bëja qejfin vëllaqos tënd të trullësuar. Të lutem.”

Kjo më shkund pak. “Zotëri ti po sillesh fare çuditshëm.”

“Më premtë se do të mësosh përmendsh rruginën nëpër të, që nëse ndonjëherë ke nevojë të mund ta manovrosh në errësirë. Të lutem.”

Vëllezërit e vegjël të shoqeve të mia, të gjithë merren me lodra *Skalekstrik*, *BMX* ose *Tap Tramp*—pse vallë mua më bie të kem një që e bën këtë dhe thotë fjalë si “manovrim” dhe “i lig?” Zoti e di

se si do të mbijetojë në Grejvsend nëse është gej. Ia shpupuris flokët. “Në rregull, të premtoj se do ta mësoj përmendësh labirinthin tënd.” Pastaj Xhako më përqafoi, që është e çuditshme sepse Xhako nuk është i dhënë pas përqaftimeve. “Hej. Nuk shkoj larg ... Do ta kuptosh kur të rritesh, dhe—“

“Do të shpërngulesh tek i dashuri yt?”

Në këtë pikë s’duhet as të befasohem. “Po.”

“Kujdesu për veten, Holli.”

“Vini është i mirë. Sapo mami të mësohet me idenë, do të mund ta takojmë njëri-tjetrin-dua të them, ne prapë u takuam me Brendanin edhe pasi ai u martua me Ruthin, apo jo?”

Por Xhako thjesht e fut kapakun e kartonit me labirinthin e tij thellë në çantën time të shpinës, më hedh një shikim për herë të fundit, dhe zhduket.

• • •

MAMI SHFAQET ME koshin me qilimat e lokalit në katin e parë, a thua se ajo nuk po rrinte në pritje. “Nuk po tallem. Je e dënuar. Ngjitu lart përsëri. Ke provime javën e ardhshme. Është koha ti përveshësh krahët dhe të bësh një përsëritje siç duhet.”

Kapem për parmakun e shkallës. “ ‘Oxhaku jonë rregullat tona’, the ti. Mirë. Unë nuk i dua rregullat tua, oxhakun tënd, apo të më godasësh sa herë që nxelesh. Ti nuk do ta duroje atë. Apo jo?”

Fytyra e mamit disi nis të dridhet, dhe nëse ajo e thotë gjënë e duhur tani, do të mërremi vesh. Por jo, ajo vetëm ma merr çantën e shpinës dhe më përqesh sikur nuk i besohet sa budallaqe që jam. “Ti kishe tru, dikur.”

Kështu unë vazhdoj shkallëve për kah kati përdhesë.

Sipër meje, zëri i saj tendoset. “Si do t’ia bësh me shkollën?”

“Shko ti atëherë, nëse shkolla qenka aq e rëndësishme!”

“Mua kurrë nuk mu dha mundësia e mallkuar, Holli. Çdoherë e kam pasur lokalim për ta udhëhequr, dhe ty dhe Brendanin, Sheronin e Xhakon për t’ju ushqyer, për t’ju veshur, dhe t’ju dërgoj në shkollë që të mos detyroheni ta kaloni jetën duke pastruar banjo, duke derdhur tavlla duhani, dhe duke e këputur shpinën tuaj, pa mos pasur kurrë një natë të qetë.”

S’më bëhet vonë. Vazhdoj tatëpjetë shkallëve.

“Por vazhdo atëherë. Shko. Mëso nga gabimet. Të jap tri ditë kohë, përpara se Romeoja të të hedh në rrugë. Ajo që meshkujve u intereson nuk është personaliteti xixëllues i vajzave, Holli. S’ka si dreqin të jetë ashtu.”

Nuk ia var veshin. Nga korridori duket Sheroni prapa banakut pranë raftëve të lëngjeve të frutave. Ajo po e ndihmon babain të bëjë furnizimin, por me sa duket ajo ka dëgjuar. Ia bëj me dorë dhe ajo ma kthen, pak me shqetësim. Nga qepeni i qilarit po jehon zëri i babait, që po e këndon nën zë ”Feri ‘Kros dhe Mërzi.” Më mirë nuk po e ngatërroj atë në këtë çështje. Në sy të mamit, ai do ta marrë anën e saj. Përpara klientëve të rregullt do të thotë “Duhet një idiot më i madh se unë të hyjë ndërmjet pulave çukitëse” dhe ata të gjithë do të tundin kokën dhe do të murmuritin, “Mjaft e drejtë kjo, Dejav.” Për më tepër, më mirë të mos jem e pranishme kur ai ta

merr vesh për Vinin. Nuk është se turpërohem, por më mirë të mos ndodhem aty. Njuki po dremit në koshin e tij. “Ti je qeni më kundërmues në mbarë Kentin.” I them që të pushoj së qari, “ti pirg i vjetër mbeturinash.” Ia përkëdhel qafën, i heq shulin derës anësore, dhe dal në Marlou Alli. Prapa meje, dera përplaset.

UEST STRITI ËSHTË shumë i ndritshëm dhe shumë i errët, si një televizor që shkrepëtin, prandaj i vë syzet e diellit dhe ata ma bëjnë botën si në ëndërr, gjallëruese dhe më reale. Fyti më dhemb dhe po dridhem pak. Askush nga lokali nuk rend pas meje. Mirë. Një kamion çimentoje po lëviz rëndë dhe shpërthimi i tij i tymosur e bën drurin e gështenjës pak të lëkundet dhe të shushurijë. Thith aromën e katranit të ngrohtë, patateve të skuqura, dhe plehrave të para një jave që derdhen nga konteineri–mbledhësit e mbeturinave janë në grevë përsëri.

Shumë zogj të vegjël e të vrullshëm sillen e rrotullohen si fyshkëllyeset me lidhëse që fëmijët i marrin për ditëlindje, ose i merrnin, dhe një bandë djemsh që luajnë kukafshehtas në parkun rreth kishës te Kruk Llej. Kape! Prapa drurit! Më lësho! Fëmijë. Stella thotë që burrat më të vjetër janë dashnorë më të mirë; me djemtë e moshës sonë, thotë ajo, akullorja shkrihet posa të marrësh në dorë konin. Vetëm Stella e di për Vinin–ajo ishte me ne të Shtunën e parë në Mexhik Bas, por ajo mund të mbajë fshehtësi. Kur ajo më mëson të pija duhan dhe unë vetëm vjellja, ajo nuk qeshte dhe nuk i tregoi askujt, dhe ajo më ka treguar gjithçka që duhet të di për djemtë. Lirisht mund të thuhet, Stella është vajza më madhështorë e gjeneratës sonë në shkollë. Krukid Llej merr kthesë sipër lumit, dhe që aty kthej në Kuan Strit lart, ku sa nuk më shkel Xhuli Uallkoti që po shtyn karrocën e fëmijës. Foshnja e saj sa nuk bie poshtë së qari dhe ajo duket e raskapitur. Ajo e la shkollën kur mbeti shtazënë. Unë dhe Vini jemi mjaft të kujdesshëm, dhe vetëm njëherë

kemi bërë seks pa mbrojtje, herën tonë të parë, dhe është fakt shkencor që vajzat e virgjëra nuk mund të ngelen shtatzënë. Ma tha Stella këtë.

BANDEROLAT JANË VARUR NËPËR Kuin Strit, a thua se për Ditën e Pavarësisë së Holli Sajksit. Gruaja skoceze në dyqanin e leshit po i ujit saksitë e varura, dhe argjendari Z. Xhilbert është duke i vedosur kutitë e unazave në vitrinat e përparme, dhe kasapët Majk e Tod po shkarkojnë një derr me kokë të prerë nga ana e pasme e furgonit, ku një duzinë kafshësh të therrura varen nga çengelat. Jashtë librarisë një turmë e ngrëzve të sindikatës nëpër kova po grumbullojnë të holla për minatorët që janë në grevë, dhe punëtorët socialist janë duke mbajtur tabela ku thuhet *MINIERË JO DËMSHPËRBLIM* dhe *THATÇER U SHPALL LUFTË PUNËTORËVE*. Ed Brubeku po e kalon rrugën i shkujdesur në biçikletën e tij. Unë futem në Indor Market që ai të mos më sheh. Ai u shpërngul në Grejvsend vitin e kaluar nga Mançesteri, ku babai i tij u burgos për vjedhje dhe agresion. Ai nuk ka asnjë shok dhe nuk tregon shenja se do ndonjë. Si rregull, kjo të shpartallon në shkollën tonë, por kur një ish nxënës i klasës së gjashtë iu mësyje, Brubeku ia shtrembëroi hundën me grusht, prandaj që atëherë është lënë i qetë. Ai e nget biçikletën pranë meje pa më parë, me një grip peshkimi të lidhur për shtyllën e tërthortë të biçikletës, dhe unë ec më tej. Pranë makinave të lojërave për fëmijë, një performues rruge po luan muzikë funeralesh në klarinet. Dikush hedh një monedhë në kutinë e tij dhe ai ia plas kolonës zanore nga *Dallas*. Kur mbërrij te Mexhik Bas Rekords memzi shoh brenda. Po shikoja R-në nga Ramones. Vini thotë se ai e shikonte H-në për Holli, si e nxehtë dhe e pshorë. Ka edhe ca gitara të dorës së dytë përgjatë anës së pasme të dyqanit. Vini mund të luajë pjesën hyrëse të “Staruej tu Hevën”, edhe pse ai kurrë nuk kaloi përtej kësaj pike. Do të mësohem të luaj në gitarën e Vinit kur ai të jetë në punë. Ne të dy mund të formojmë një bandë. Pse jo? Tina Uejmuth është një vajzë dhe ajo është basiste në Toking Heds. Përfytyro fytyrën e mamit kur të

deklarojë "Ajo nuk është më ime bijë," pastaj më sheh në majë të toplistës. Problemi i mamit është se ajo për askënd nuk ka ndjerë dashuri kaq të thellë si unë dhe Vini për njëri-tjetrin. Ajo shkon mirë me babin, padyshim, edhe pse duke mos qenë katolik dhe irlandez ai kurrë nuk u pa me sy të mirë nga familja e saj në Kork. Kushërinjtë më të mëdhenj se unë shkriheshin kur më tregonin se babi e la shtatzënë mamim me Brendanin përpara se të martoheshin, por ata tanimë kanë qenë të martuar për 25 vite, që nuk është aq keq, ma merr mendja, por prapëseprapë, mami nuk ka aq lidhje të mrekullueshme me babin si unë dhe Vini. Stella thotë se unë dhe Vini jemi shpirtëra binjakë. Ajo thotë se është e qartë që jemi krijuar për njëri-tjetrin.

• • •

JASHTË BANKËS NATU_{EST} në rrugën Milton, ndesh në Brendanin. Flokët e lëpira prapa, kravatë nga kashmiri, dhe xhaketën të varur pas supit, do të mendonit sikur është nisur për në shkollën për të pashmit, jo në zyrat e Skot dhe Konuej. Vëllai im i madh është pak si idhull në mesin e motrave të mëdha të shoqeve të mia—mua më vjen për të vjellë nga kjo. Ai u martua me Ruthin, vajzën e shefit të tij, Z. Konuej, në bashkinë e qytetit me një kremtim madhështor te Shoser Kantri Klab. Unë nuk isha shoqëruese e nuses sepse unë nuk vesh fustane. Sidomos fustane që të bëjnë të dukesh si gjësend nga koleksioni i *Iku bashkë me erën*, ndërkaq Sheroni dhe mbesat e Ruthit i bënë këto gjëra, dhe një grumbull njerëzish nga familja jonë në Kork erdhën. Brendani është djali flori i mamit dhe mami është nëna flori e Brendanit. Më vonë ata do ta shqyrtojnë çdo imtësi të asaj që jam duke thënë tani.

"Mirmëngjes," i them. "Si po ia kalon?"

"Jo keq. Gjithçka në rregull te Kapiteni?"

“Është mirë. Mami është e përmbushur me harenë e pranverës sot.”

“Po?” Buzëqesh Brendani, i habitur. “Si mundet?”

Unë i mbledh supet. “Duhet të jetë çuar në këmbë të djathtë.”

“Shkëlqyeshëm.” Atij i bie në sy çanta ime e shpinës. “Mos po shkojmë gjë në ekskurzion?”

“Jo, tamam. Do të përsëris në gjuhë frengje te Stella Jervud, pastaj do të rri një natë atje. Provimet janë javën e ardhshme.”

Kjo i le përshtypje vëllait tim. “Më vjen mirë për ty motërzë.”

“A është Ruthi më mirë?”

“Jo dhe aq. Zoti e di se pse quhet ‘përzjerje e mëngjesit’ kur bëhet më keq në mes të natës.”

“Mbase kështu nëna natyrë të kalit për kur të lind foshnja,” ia hedh fjalën unë. “Gjithë ato netë pa gjumë, grindjet, e vjellura ... duhet forcë.”

Vëllai im nuk bie në grackë. “Ma merr mendja ashtu duhet të jetë.” Është e vështirë të përfytyrosh Brendanin si babain e dikujt por, sa të vijnë Krishtëlindjet, do të bëhet.

Pas krahëve tonë NatUesti i hap dyert dhe nëpunësit e bankës fillojnë të futen brenda. “Nuk është se Z.Konuej do ta heqë nga puna dhëndrin e tij,” i them Brendanit, “por a nuk filloni me punë në nëntë?”

“Ashtu është. Shihemi nesër nëse kthehesh nga maratoni i përsëritjes. Mami na ka ftuar për drekë. Ditën e mirë.”

“Veçmë është dita më e mirë e jetës simë.” Ia them këtë vëllait, dhe në mënyrë të tërthortë, edhe mamit. Një rrezëllimë të buzëqeshjes së tij të spikatur, dhe Brendani më humb nga sytë, e bashkohet me lumin e njerëzve me kostume dhe uniforma, të gjithë duke shkuar në punë në zyra, shitore e fabrika.

TË HËNËN do të marr një çelës të kalitur për derën e përparme të Vinit, por sot shkoj nga rruga e zakonshme e fshehtë. Rrugës së quajtur Grouv, pak më përpara prej zyrës së taksive, është një rrugicë, gjysmë e fshehur nga një kosh përplot me qese plehrash me erë të pelenave të mbushura. Një mi ngjyrë kafe po më vështron si të ishte ndonjë i vetëquajtur aristokrat. Unë ec nëpër rrugicë, kthehem djathtas dhe tani jam ndërmjet gardhit të oborit të pasëm të Pikok Stritit, dhe murit të zyrës së taksive. Teposhtë më larg, shtëpia e fundit përpara prerjes së hekurudhës, ajo është shtëpia e Vinit. Unë shtrydhem të kaloj mospërmas gardhit dhe zvarritem përmes pjesës së pasme të oborit të tij. Kullosa dhe barri më arrijnë deri te mesi dhe pemët e kumbullës tanimë janë duke dhënë fruta, ndonëse shumica e frutave do të shkojnë te krimbat dhe grerëzat. Vini thotë se ai nuk mund të përkulet që ti mbledhë. Është si pylli të Bukuroshja e Fjetur që e mbyty kështjellën për 100 vjet kur të gjithë janë në gjumë. Vini duhet të mbajë kopshtin të pastërt për tezen e tij por ajo jeton në Kings Lin dhe asnjëherë nuk vjen për vizitë, dhe sidoqoftë, Vini është djali i motoreve, dhe jo një kopshtar. Sapo të vendosem këtu do ta sjell në vehte këtë xhungël. I duhet dorë gruaje, kjo është e tëra. Mund të filloj sot pas orës për kitarë. Është një hangar të qoshja, gjysmë i fshehur nga ferrat me pajisje për kopshtari dhe një kositëse bari. Luledielli, trëndafila, manushaqe, karafila, livando, dhe barishte në saksitë të vogla balte, këto do të mbjell. Do të bëj kuleçë dhe byrek kumbullash dhe torte nga kafeja, dhe Vini do të thotë, “Krisht, Holli, si kam mundur t’ia bëj pa ty më parë?” Gjithë revistat thonë se rruga për të zemra e një

mashkulli është përmes barkut të tij. Nga fuçia e shiut një shkurre e purpurtë në formë gishti gëlon me flutura të bardha, laramane dhe e qëndisur; si të ishte e gjallë.

• • •

DERA E PASME nuk mbyllet asnjëherë sepse Vini e ka humbur çelësin. Kutitë tona të picave dhe gotat e verës janë ende në lavaman që mbrëmë, por asnjë gjurmë nga kafjalli–Vini me siguri ka fjetur vonë dhe ka nxituar për në punë, si zakonisht. Gjithë shtëpia ka nevojë për një heqje pluhuri dhe fshesë me korent. Njëherë një kafe dhe i vjen rradha edhe punës, megjithëse- hëngra vetëm gjysëm Uiatbiksi përpara se mami të fillonte të sillej si Mohamed Ali me mua. Harrova të blej cigare rrugës për këtu–më doli nga mendja pasi takova Brendanin–por Vini mban ca mbi tavolinën pranë krevatit, andaj unë ngjitem lehtas nëpër shkallët e pjerrta për te dhoma e tij e gjumit. Dhoma jonë e gjumit, duhet të them. Perdet janë ende të lëshuara dhe bie era çorape të mbajtura, andaj e lë dritën të depërtojë, e hap dritaren, kthehem, dhe shkulem vendit nga frika, sepse Vini është në shtrat, dhe duket sikur e ka dhjerrë veten. “Jam unë, unë.” Dërdëllis ngapak. “Më fal, unë, unë, unë mendova se ishe në punë.”

Ai e vendos dorën te zemra, dhe qesh në njëfarë mënyre, sikur sapo është qëlluar. “Krisht, Holli. Mendova se ishe ndonjë hajdut! ”Edhe unë qesh disi. “Ti qenke ... në shtëpi.”

“Nje gabim në listën e detyrave–sekretaresha e re është një dështake e ndyrë, prandaj Kev u lajmërua të më thotë se sidoqoftë sot e kam pushim.”

“Shkëlqyeshëm,” ia kthej. “Shumë mirë sepse ... unë kam një befasi.”

“Mirë, më pëlqejnë befasitë. Po, ta vësh ibrikun njëherë, si thua? Do të zbres menjëherë. Dreqin, çfarë po them? Më ka mbaruar kafeja–bëhu sheqerkë, dil me vrap te Stafa dhe blej një kavanoz Golld Blend. Do të shlyhem kur të kthehesh.”

Pikësëpari, më duhet ta them këtë: “Nëna e morri vesh për ne Vin.”

“Çfarë? Oh.” Ai duket i menduar. “Ashtu? Si, hmm ...”

Përnjëherë kam frikë se nuk do të më dëshirojë. “Jo aq mirë. Në fakt, doli pak nga shinat. Më tha se nuk do të mund të të shoh më, dhe njashtu më kërcënoi se do të më mbyllte në qilar. Si pasojë unë ika. Prandaj ...”

Vini më shikon me ankth, pa kuptuar ku po e hedh fjalën.

“Pra, a mundet ... unë ashtu të rri me ti? Të paktën, vetëm për një kohë të shkurtër.”

Vini e gëlltit pështymën. “Në-rregull ... Mirë. E kam të qartë. Epo. Mundet.”

Nuk tingëllon tamam si të mundet. “A është kjo një po Vin?”

“P-hoo. Sigurisht. Po. Por tani me të vërtetë më duhet ajo kafeja.”

“E ke me gjithë mend? Oh, Vin!”

Lehtësimi më vjen si një banjë e ngrohtë. E përqafoj. Ai është me djersë. “Ti je më i miri, Vini.”

Kisha frikë se nuk do të më ...“

“Nuk mund ta lëmë një kotele leshtore joshëse e gërhitëse të flejë nën urë, apo? Por ta them të drejtën. Hol. Më duhet kafe njëjtë siç i duhet Drakulës ...” Nuk arrin ta mbarojë fjalinë sepse unë filloj ta puthë, Vinin tim, të dashurin tim që ka qenë në Nju Jork dhe ia ka shtrënguar dorën

David Bërnit, dhe dashuria ime për të turret si shigjetë, si një bojler që nxehet, dhe e tërheq atë mbrapsht dhe rrokullisemi mbi një kodër me gunga nga jorgani , por kodra përpëlitet dhe dora ime e tërheq çarshafin dhe ja ku shfaqet shoqja ime më e mirë Stella Jervud. Lakuriq. Sikur të isha në një ëndërr të keqe seksuale, vetëm se nuk është një ëndërr.

Thjesht ... mbetem me gojë hapur duke shikuar legenin e saj, gjersa nuk më drejtohet, “Nuk mund të duket edhe aq ndryshe nga i joti, si thua?”

Pastaj i zgurdulloj sytë kah Vini, që duket sikur e ka bërë në brekë, por pas pak e bën një nënqeshje me vrull: “Nuk është ashtu siç duket.”

Stella, gjakftohtë sa më s’ka, mbulohet me çarshaf dhe i thotë Vinit, “Mos u bëj kokëtrashë. Kjo është pikërisht ashtu siç duket, Holli. Do të të tregonim por, siç e sheh, jemi zënë ngushtë nga ndodhitë. E vërteta është se të kanë lënë. Nuk është e këndshme, por na ndodh të gjithëve, epo, shumicës prej neve, pra *c’est la vie*. Mos u brengos, ka sa të duash të tjerë si Vini. Prandaj pse nuk shkon sa nuk është bërë vonë? Me atë pak denjësi që të ka mbetur?”

KUR PUSHOJ së qari, më në fund, e gjej veten në një shkallë të ftohtë në një vend të vogël të oborit të godinës, me pesë ose gjashtë kate të tullave të vjetra, dhe dritareve të ngushta të errëta në secilën anë. Bari ka mbirë përmes pllakave të shtruara dhe farat e luleradhiqes fryhen përreth si bora në glob dëbore. Pasi e përplasa derën e Vinit, këmbët më sollën këtu, në anën e pasme të spitalit të përgjithshëm të Grejvsendit, ku Dr. Marinusi ma hoqi qafe zonjushën Konstantin kur isha shtatë vjeçe. A e godita Vinin? Ishte sikur hiqesha zvarrë. Nuk merrja dot frymë. Ai më kapi për kyçi dhe më dhëmbi—ende më dhëmb—dhe Stella ulërinte, “Rritu dhe hiqmu sysh, Holli. Kjo është jeta reale dhe jo një epizodë e serialit Dinastia!” dhe unë renda jashte, duke e përplasur

derën e hyrjes dhe sa më me nxitim që mundesha, kudo, askund, diku ... e dija se në momentin që do të ndaloja, do t'ia plasaj të qarës, do quravitesha, dhe pastaj spiunët e mami do të më shihnin dhe do të më kallëzonin, dhe kjo do të ishte qershia mbi tortë. Sepse mami kishte të drejtë. E doja Vinin si të ishte pjesë e imja, dhe ai më deshi si një çamçakëz. Më pështyu kur më doli shija, e hapi një tjetër, dhe e futi në gojë, dhe jo cilëndo, po Stella Jervudin. Shoqen time më të mirë. Si mundi të bënte këtë? Po ajo si mundi?

Mjaft qave! Mendo për diçka tjetër ...

HOLLI SAJKSI dhe ngjarjet e çuditshme, Pjesa e parë. Isha shtatë vjeçe në vitin 1976. Nuk ra shi gjithë verës dhe kopshtet u bënë ngjyrë kafe, dhe më kujtohet si mbaja rradhë me kova në fund të Kuin Stritit me Brendanin dhe mamin për ujë nga tubacioni, thatësira u bë aq keqe. Halucinacionet më filluan atë verë. Dëgjoja zëra në kokë. Jo të xhindosur, veçanarisht të frikshëm, ose pallavra, madje, jo me të parën ... Njerëzit e radios, I quaja, sepse në fillim mendoja se kishte një radio në dhomën tjetër. Vetëm se kurrë nuk pati radion në dhomën tjetër. Ishin më të kthjellët gjatë natës, por I dëgjoja edhe në shkollë, nëse ishte mjaft qetë, të themi, në test. Tre ose katër zëra murmurisnin njëherësh, dhe asnjëherë nuk e kuptova tamam se çfarë po thonin. Brendani kishte përmendur diçka për spitalet mendore dhe burrat me mantela të bardhë, andaj nuk guxoja t'ia thoja askujt. Mami ishte shtatzënë me Xhakon, babi vinte rrotull në lokal, Sheroni ishte vetëm tre vjeçe, dhe Brendani ishte një teveqel, që atëherë. E dija se nuk është normale të dëgjosh zëra, por ata nuk më bënin keq, pra mbase ishte një nga ato fshehtësitë me të cilat njerëzit jetojnë.